

**KONTRATE SHITJE
(KUOTASH)**

Sot, ne Tirane, me date *05/06/2003* (dy mije e tre), ne Tirane, lidhet kontrata e shitblerjes se kuotave ndermjet paleve kontraktuese si vijon :

Shitesi : Enkeleidi Zoraqi, shtetas shqiptar, i biri i Nikolles, lindur ne Tirane, me 13.03.1969, banues ne Tirane, Rr. Durresit, pll.102, shk.2, ap.9, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte nr. Z0478900
Dhe

Bleresi : Gentian Likaj, shtetas shqiptar, i biri i Safetit, lindur ne Durres, me dt. 11.08.1969, banues ne Tirane, Rr."Muhamet Gjollasha" pll.142, shk.2, ap.18, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte nr. Z0539998, si dhe z. **Dhimiter Shuli**, shtetas shqiptar, i biri i Llukanit, lindur ne Fier, me dt. 28/09/1966, banues ne Tirane, Rr."Komuna e Parisit", pll. Kontakt, shk.3, ap.7/F, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte nr. 1072094

Objekti : Shitje e plote e 33,33% te Kuotave te Kapitalit themeltar nga ana e ortakut Enkeleidi Zoraqi te poseduara prej tij ne shoqerine "Communication Progress" shpk, kundrejt vleres se tyre nominale 1000 leke per kuote perkatesisht dy ortakeve te tjere te kesaj shoqerie ne mase te barabarte (perkatesisht secilit 16,66%).

Baza Ligjore : Kodi Civil i RSh, neni 705, Ligji per Shoqerite tregtare, Akti Themelimit dhe Statuti i Shoqerise.

Neni 1

Pronesia

z. Enkeleidi Zoraqi, rezulton te jete pronar i 33,33 kuotave ose i 33,33 % te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare "Communication Progress" shpk, person juridik shqiptar, regjistruar me vendim te Gjykates se Tiranes nr. 20351, date 25.11.1998, ne baze te Statutit, Aktit te Themelimit dhe Vendimit te Gjykates se Tiranes per njohjen si Person Juridik te shoqerise "Communication Progress" shpk si dhe konfirmimit perkates e te azhornuar bere ne Zyren e Regjistrimit tregtar te Gjykates se Tiranes.

Neni 2

E drejta e parablerjes

Ortaket e tjere te shoqerise "Communication Progress" shpk pasi njihen me oferten e bere nga ortaku Enkeleidi Zoraqi, me objekt shitje totale te kuotave te tij, brenda afateve ligjore te percaktuara ne ligjin per funksionimin e shoqerive tregtare dhe statutit te shoqerise, ushtrojne te drejten e parablerjes duke u shnderuar ne bleres efektive te ketyre kuotave.

Neni 3

Cmimi



Z. Enkeleidi Zoraci, (shitesi) deklaron dhe garanton se deshiron t'iu shese e transferoje bleresave pasurine e luajtshme te llojit "Kuota te kapitalit themeltar" te shoqerise tregtare "Communication Progress" shpk, te perbera prej 33,33 (tridhjetë e tre pike tridhjetë e tre) kuota, me nje vlere prej 1000 leke (nje mije) per Kuote, perkatesisht secili 16,66 kuota (gjashtembdhjetë pike gjashtë dhjetë e gjashtë). Shitesi deklaron se i shet bleresave ne teresi 33,33 kuota ose 33,33% dhe bleresat deklarohen se jane dakort te blejne 33,33 kuota te kapitalit themeltar te shoqerise Communication Progress shpk, perkatesisht secili nga 16,66 kuota ose 16,66 % te kapitali, me cmimin prej 1000 leke per kuote.

Neni 4

Likujdimi ndermjet paleve

Palet deklarojne se cmimi i pergjithshem i kuotave te shitura, i perbere prej 33 333 lekesh i eshte shlyer paraprakisht shitesit nga bleresat ne mase te plote dhe se ndermjet tyre nuk ka asnje detyrim tjeter financiar.

Nderkohe, pas nenshkrimit te kesaj kontrate shitblerje kuotash, bleresave iu lind e drejta t'i kerkojne Administratorit/ve te shoqerise tregtare "Communication Progress" shpk te marre masat e nevojshme per pasqyrimin e ketij ndryshimi te ortakerise se shoqerise, prane Regjistrimit tregtar te Gjykates se Tiranes, ne nje kohe sa me te shpejte dhe marrjen e vendimit perkates nga Gjykata e Shkalles se Pare te Tiranes lidhur me kete ndryshim.

Neni 5

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, shitesi z. Enkeleidi Zoraci humbet te drejten e pronesise mbi 33,33 kuotat ne kapitalin e Communication Progress shpk duke mos gezuar me te drejten e te qenurit ortak ne kete shoqeri si dhe administrator i saj.

Ndersa bleresat Gentian Likaj dhe Dhimiter Shuli vazhdojne te mbeten ortake te shoqerise Communication Progress shpk dhe administratore te saj duke zoteruar qe ketej e tutje secili perkatesisht 50 kuota ose 50% te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie. Si rrjedhim ata do te vazhdojne t'i nenshtrohen te gjitha pergjegjesive/detyrimeve dhe te drejtave qe burojne nga te qenurit ortake e nje shoqerie tregtare, dhe duke vepruar ne te ardhmen ne unitet me njeri tjetrin per mbarevajtjen ekonomike te shoqerise.

Neni 6

Hyrja ne Fuqi

Kjo kontrate hyn ne fuqi ditën e nenshkrimit te po kesaj kontrate.

Neni 7

Te tjera

Kjo kontrate shitblerje kuotash hartohet ne kater kopje origjinale, secila ne dy flete, me nga nje faqe, dhe pasi gjendet konform vullnetit te plote te paleve kontraktore firmoset rregullisht prej tyre.

Shitesi

Enkeleidi Zoraci
[Signature]

Bleresi

Gentian Likaj
Dhimiter Shuli
[Signatures]